



## Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

### Raport i Misionit të OSBE-së 02/2010 mbi Monitorimin e Kuvendit të Kosovës 1 mars 2010 – 30 prill 2010

#### Pikat kryesore

- **Kuvendi miraton Rregulloren e re të Punës**
- **Kuvendi miraton Projektligjin për Institucionin e Avokatit të Popullit**
- **Kuvendi shqyrton raportet vjetore të pesë institucioneve të pavarura**
- **Kuvendi miraton një deklaratë për funksionimin e strukturave paralele Serbe në Kosovë**
- **Kuvendi debatton për protestën e 10 shkurtit 2007**

#### **1. Historik**

Ky raport monitorimi numër 67 është përpiluar në pajtim me kushtet e punës për Shtyllën e Tretë të UNMIK-ut për Ndërtimin e Institucioneve (OSBE), Monitorimi i Kuvendit të Kosovës, të datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në respektimin e rregullores së punës të miratuar në seancën plenare të datës 20 maj 2005, siç është ndryshuar dhe plotësuar në seancën plenare më 1-2 qershor 2006 dhe në seancën plenare më 18 shtator 2007.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar shtatë seanca të rregullta plenare, të mbajtura më 4 mars, 18 mars, 1 prill, 8 prill, 15 prill dhe më 29 prill, si dhe ka monitoruar tetë takime të Kryesisë, më 1 mars, 9 mars, 16 mars, 30 mars, 6 prill, 13 prill, 20 prill dhe më 28 prill.

#### **2. Vështrim i përgjithshëm**

Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (Partia Demokratike e Kosovës/PDK) dhe Z. Xhavit Haliti (PDK), anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kryesuan **seancën plenare të mbajtur më 4 mars.**

- Tetëdhjeteshtatë Deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të mbajtur më 4 mars.<sup>1</sup>
- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare të 4 marsit ishin:
  - Debati për funksionimin e strukturave paralele serbe në territorin e Kosovës (Debati është mbajtur me kërkesë të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD). Në fillim të debatit, propozuesi i debatit Z. Lulzim Zeneli (LDD) ka mbajtur një fjalim hyrës; pas tij përfaqësuesit e grupeve parlamentare kanë mbajtur fjalimet e tyre dhe po ashtu disa Deputetë tjerë. Në fund të debatit është miratuar një deklaratë me 52 vota për dhe 2 vota kundër<sup>2</sup>).

<sup>1</sup> Kjo shifër është shpallur nga Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës plenare. Megjithatë kjo shifër nuk përputhet me numrin e përgjithshëm të votave në rendin e ditës sepse nuk përfshin abstenimet dhe anëtarët që nuk kanë deklaruar fare votën e tyre.

<sup>2</sup> Teksti i deklaratës është si në vijim: “(a) Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në tërë territorin e Kosovës, duke garantuar ruajtjen e tërësisë territoriale dhe pacenueshmërinë e kufijve të pranuar ndërkombëtarisht të Republikës së Kosovës; (b) Kuvendi i Republikës së Kosovës mirëpret Deklaratën e Grupit Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën, të datës 8 shkurt 2010, në të cilën shprehet mbështetja e plotë për domosdoshmërinë e

Kryetari i Kuvendit, Z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe Z. Etem Arifi (Partia Demokratike e Ashkalive /PDAK), anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kryesuan **seancën plenare të mbajtur më 11 mars**.

Gjashtëdhjetekatër Deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të mbajtur më 11 mars.

- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare, të mbajtur më 11 mars ishin:
  - Koha për pyetje parlamentare
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën Administrative (Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institucionin e Avokatit të Popullit (Projektligji është miratuar në parim me 58 për dhe 8 vota kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (Projektligji është miratuar në parim me 57 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtim i rekomandimit të Komisionit për Legjislacioni dhe Gjyqësi në lidhje me emërimin e një anëtar në Komisionin e Kërkesave Pronësore (Emërimi është miratuar me 53 vota për dhe asnjë votë kundër).

Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe Z. Ibrahim Gashi (Aleanca Kosova e Re/AKR), anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kryesuan **seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 18 mars**.

- Gjashtëdhjetetë Deputetë ishin të pranishëm në seancën e mbajtur më 18 mars.
- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare, të mbajtur më 18 mars, ishin:
  - Debati për Projekt-strategjinë për energjinë për periudhën 2009-2018 (Ministrja e Energjisë dhe Minierave ka mbajtur fjalimin hyrës për projekt-strategjinë, vijuar nga Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion, kryetarët e grupeve parlamentare dhe disa anëtarë tjerë të Kuvendit. Në fund të debatit, Kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion autorizoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion ta shqyrtojë projekt-strategjinë dhe që t'i dorëzojë rekomandimet në Kuvend, për të cilat do të votohej në seancën e ardhshme plenare.

Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe Z. Xhavit Haliti (PDK), anëtar i Kryesisë, kryesuan **seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 1 prill**.

---

forcimit të përpjekjeve të institucioneve të Republikës së Kosovës për veriun e Kosovës; (c) Kuvendi i Republikës së shpreh përkushtimin e tij për të siguruar që të gjithë shtetasit e Kosovës të gëzojnë mbrojtjen e shtetit ligjor. Kuvendi mirëpret përkrahjen e Bashkimit Evropian e të bashkësisë ndërkombëtare për të bërë të mundur që të gjithë qytetarët të kenë përfaqësim demokratik në pushtetin qendror dhe lokal, të përfitojnë nga shërbimet e investimet dhe të kenë qasje në drejtësi, dhe (ç) Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson përkushtimin e tij ndaj vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimit sipas Propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, Kushtetutës dhe legjislacionit të miratuar prej tij.”

- Nëntëdhjetenjë Deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të Kuvendit të mbajtur më 1 prill.
- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare, të mbajtur më 1 prill, ishin:
  - Koha për pyetje parlamentare
  - Shqyrtimi i tretë i Projektligjit për Masat Antidamping (Projektligji është miratuar më 68 vota për dhe 1 votë kundër)
  - Shqyrtimi i propozimit të qeverisë në lidhje me emërimin e anëtarëve të bordit për Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës (Emërimet e anëtarëve janë miratuar me 53 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Ratifikimi i marrëveshjes për kredi dhe financim ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qeveritare Gjermane KfW<sup>3</sup> (Marrëveshja është ratifikuar me 91 vota për dhe 3 vota kundër)
  - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport dhe Telekomunikacion në lidhje me projekt-strategjinë për energjinë për periudhën 2009-2018 (Rekomandimet janë miratuar me 54 vota për dhe 6 vota kundër)

Z. Xhavit Haliti (PDK), anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kryesoi **seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 8 prill.**

- Tetëdhjetedy Deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare, të mbajtur më 8 prill.
- Pika kryesore e rendit të ditës të seancës plenare, të mbajtur më 8 prill, ishte:
  - Debati për protestën e “Vetëvendosjes” më 10 shkurt 2007. (Kryesuesi i seancës ka mbajtur fjalimin hyrës, përcjellë nga fjalimet e kryetarëve të grupeve parlamentare dhe disa anëtarë tjerë të Kuvendit. Debati është mbyllur pa votim për kërkesat e parashtruesve.<sup>4</sup>)

Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe Z. Naim Maloku (AAK), anëtar i Kryesisë, kryesuan **seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 15 prill.**

- Tetëdhjetepesë anëtarë të Kuvendin ishin të pranishëm në seancën plenare, të mbajtur më 15 prill.
- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare, të mbajtur më 15 prill, ishin:
  - Koha për pyetje parlamentare
  - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore (Projektligji është miratuar në parim me 30 vota për dhe 28 vota kundër.)

<sup>3</sup> Grupi Bankar KfW është bankë për zhvillim në pronësi të Qeverisë Gjermane, me seli në Frankfurt. Emërtimi i tij origjinal rrjedh nga gjuha gjermane Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), që do të thotë Institut për Kredi të Rindërtimit, dhe është pronë e Qeverisë Federale të Gjermanisë dhe të Landeve të Gjermanisë. Qëllimi i kësaj marrëveshje është ndërtimi i një linje 400 kilovoltëshe (kV) të transmisionit të energjisë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. KfW do t'i ofrojë Qeverisë së Kosovës 33,500,000 EUR, të ndara në kontribut financiar deri në 16,500,000 EUR dhe një kredi deri në 17,000,000 EUR.

<sup>4</sup> Vëreni që “këshilli kundër procesit gjyqësor të Albin Kurtit, i përbërë nga anëtarët e Vetëvendosjes dhe disa OJQ vendore, i ka dorëzuar Kryesisë së Kuvendit një peticion publik me nënshkrimet e 145,769 banorëve që bënte thirrje për “ndërprerjen e procesit gjyqësor kundër Albin Kurtit dhe nisjen e hetimeve për vrasjet që kanë ndodhur në protestën e datës 10 shkurt 2007.” Gjithashtu, ky “këshill” ka kërkuar nga Kryesia mbajtjen e një seance plenare për të diskutuar këto çështje. Më 16 mars 2010, Kryesia diskutoi për peticionin dhe vendosi të kërkojë një opinion për këtë çështje nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, dhe nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Më pas, të dy komisionet i kanë rekomanduar Kryesisë mbajtjen e një debati për rastin e Albin Kurtit për shkak se ishin përmbushur kushtet ligjore dhe për këto arsye Kryesia ka caktuar debatin plenar për çështjen në fjalë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ujitjen e Tokave Bujqësore  
(Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe 2 vota kundër)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatat  
(Projektligji është miratuar në parim me 62 për dhe 1 votë kundër)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Grevat  
(Projektligji është miratuar në parim me 39 për dhe 14 vota kundër)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Energjinë Elektrike  
(Projektligji është miratuar në parim me 47 vota për dhe 8 vota kundër)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimet Postare  
(Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për dhe 1 votë kundër)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës  
(Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe 1 votë kundër)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar  
(Projektligji është miratuar në parim me 54 vota për dhe 7 vota kundër)
- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Përmbarimin e Sanksioneve Ndërkombëtare  
(Projektligji është miratuar në parim me 56 vota për dhe 1 votë kundër)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e Drejtorit dhe Zëvendës-drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjetës dhe Mbeturina  
(Emërimet janë miratuar me 57 vota për dhe 7 vota kundër)
- Shqyrtimi i propozimit për themelimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media  
(Propozimi është miratuar me 63 vota për dhe 2 vota kundër)
- Informatë nga Grupet Parlamentare të LDK-së dhe të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe Z. Naim Maloku (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës/AAK), anëtar i Kryesisë, kryesuan **seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 29 prill**.

- Nëntëdhjetë e katër Deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare, të mbajtur më 29 prill.
- Pikat kryesore të rendit të ditës së seancës plenare, të mbajtur më 29 prill, ishin:
  - Koha për pyetje parlamentare
  - Shqyrtimi i dytë i propozim-Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës  
(Propozim-Rregullorja e Punës është miratuar me 90 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Kosovës  
(Kjo pikë është shtyrë për seancën e ardhshme plenare<sup>5</sup>)
  - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Pagat e Nëpunësve Civil  
(Kjo pikë është shtyrë për seancën e ardhshme plenare)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mjekësi ligjore  
(Projektligji është miratuar me 70 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale  
(Projektligji është miratuar me 72 vota për dhe asnjë votë kundër)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për tatimin në pronë të paluajtshme

<sup>5</sup> Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil dhe i Projektligjit për Pagat e Nëpunësve Civil janë shtyrë për në seancën plenare të 13 majit, për t'i dhënë më shumë kohë Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media dhe Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për të diskutuar dhe harmonizuar rekomandimet e tyre në lidhje me këto dy projektligje.

- (Projektligji është miratuar në parim me 53 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për kontestet administrative  
(Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për metrologjinë  
(Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Komisionit të Pavarur të Mediave  
(Raporti është miratuar me 60 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik  
(Raporti është miratuar me 52 vota për dhe dy vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Organit Shqyrtues të Prokurimit  
(Raporti është miratuar me 49 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Agjencisë Kundër Korrupsionit  
(Raporti është miratuar me 58 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtimi i raportit vjetor 2009 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës  
(Raporti nuk është pranuar me 15 vota për dhe 49 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Ankesa  
(Emërimet nuk janë pranuar me 20 vota për dhe 38 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve të Bordit Menaxhues të Institutit Gjyqësor të Kosovës  
(Emërimet janë miratuar me 45 vota për dhe 18 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për punësimin e zyrtarëve shtesë korrektues në burgun e Dubravës<sup>6</sup>  
(Propozimi është miratuar me 61 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për punësimin e stafit të Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar<sup>7</sup>  
(Propozimi është miratuar me 65 vota për dhe tri vota kundër.)
- Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejta të njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione në lidhje me zgjatjen e afatit për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje  
(Kërkesa është miratuar me shumicën e votave për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për emërimin e një anëtari të Komisionit Kosovar të Konkurrencës  
(Emërimi është miratuar me 46 vota për dhe 11 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të qeverisë për emërimin e një anëtari të bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit  
(Emërimi është miratuar me 46 për dhe 14 vota kundër.)

### **3. Praktikrat dhe procedurat parlamentare të seancave të Kuvendit**

#### Procesi legjislativ

- Gjatë periudhës së monitorimit, Kuvendi ka miratuar gjashtë ligje, si në vijim:

<sup>6</sup> Qeveria ka propozuar punësimin e 71 zyrtarëve korrektues për burgun e Dubravës.

<sup>7</sup> Qeveria ka propozuar punësimin e 17 punonjësve në Agjencinë e sapothemeluar për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar.

Emri	Komisionet funksionale	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Afati kohor
Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale <sup>8</sup>	Komisioni për punë të brendshme dhe siguri	29 tetor 2009	29 prill 2010	6 muaj
Ligji për diasporën e Kosovës	Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sporte	29 tetor 2009	15 prill 2010	5.5 muaj
Ligji për shërbime postare	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikime	29 tetor 2009	15 prill 2010	5.5 muaj
Ligji për mjekësinë ligjore	Komisioni për legjislacion dhe çështje gjyqësore	28 janar 2010	29 prill 2010	3 muaj
Ligji për përmbarimin e sanksioneve ndërkombëtare	Komisioni për punë të jashtme	28 janar 2010	15 prill 2010	2.5 muaj
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin në vlerë të shtuar	Komisioni për buxhet dhe financa	11 mars 2010	15 prill 2010	1 muaj

*Koment: Rregulla 35.6 përcakton se “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Pesë nga projektligjet e lartcekura janë miratuar nga Kuvendi pas afatit të kërkuar me rregullën 35.6 dhe vetëm një komision përgjegjës funksional ka kërkuar nga Kuvendi zgjatje të afatit, që nuk ka qenë në pajtueshmëri me rregullën 35.6. Shumë raporte të mëhershme të monitorimit të OSBE-së kishin vërejtur se Komisionet e Kuvendit po hasin në vështirësi në shqyrtimin dhe raportimin e rekomandimeve të tyre për projektligjet në pajtim me afatin kohor të përcaktuar në rregullën 35.6. Prandaj, OSBE-ja ka rekomanduar që Kuvendi të angazhojë staf mbështetës shtesë për t’i ndihmuar komisionet, ashtu që ato të mund t’i shqyrtojnë projektligjet me kohë. Në këtë kuptim, është me rëndësi të ceket se më 1 mars, Kryesia miratoi propozimin e Sekretariatit për punësimin e 13 ekspertëve për të mbështetur punën e komisioneve.<sup>9</sup> Veç kësaj, edhe komisionet duhet të bëjnë përpjekje për shqyrtimin e projektligjeve brenda afateve të kërkuara ligjore ashtu që, sipas nevojës, të kenë takime më shpesh sesa takimet aktuale një herë në javë apo një herë në dy javë.*

- Më 28 prill, Kryesia pranoi një kërkesë nga Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale për kohë shtesë prej një muaji për shqyrtimin e projektligjit për mjetet

<sup>8</sup> Më 29 dhjetor 2009, Kuvendi miratoi kërkesën e komisionit për zgjatjen e afatit për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale deri më 31 janar 2010. Megjithatë, komisioni e zgjati afatin në tre muaj.

<sup>9</sup> Kuvendi do t’i punësojë 13 ekspertë për të mbështetur komisionet në vijim: një ekspert për ekonomi dhe financa për të mbështetur Komisionin për buxhet dhe financa, një ekspert për ekonomi dhe financa për të mbështetur Komisionin për mbikëqyrjen e financave publike, një ekspert për integritet evropian për të mbështetur Komisionin për integritet evropian, një ekspert për marrëdhënie ndërkombëtare për të mbështetur Komisionin për punë të jashtme, një ekspert të shkencave teknike për të mbështetur Komisionin për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion, një ekspert për mbrojtje mjedisore për të mbështetur Komisionin për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor, një ekspert të arsimit për të mbështetur Komisionin për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sporte, një ekspert për çështje të sigurisë për të mbështetur Komisionin për mbikëqyrjen e forcës së sigurisë së Kosovës, tre ekspertë ligjorë për të mbështetur Komisionin për legjislacion dhe gjyqësi, Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe Komisionin për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione, si dhe një ekspert për partneritet evropian.

dhe produktet mjekësore, dhe u pajtua që ta përfshijë kërkesën e komisionit në rend të ditës në seancën plenare të radhës. Gjersa në seancën plenare të 29 prillit, Kuvendi miratoi kërkesën e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe Komisionin për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pagjetur dhe peticione për kohë shtesë prej 15 ditëve për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

*Koment: Rregulla 35.6 përcakton se “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Projektligji për mbrojtje nga dhuna në familje dhe projektligji për mjete dhe produkte mjekësore janë miratuar në shqyrtimin e parë në seancën plenare të 28 janarit. Afërsisht tre muaj më vonë, të dy komisionet parashtruan kërkesa për zgjatje të afatit për shqyrtimin e projektligjeve përkatëse, gjë që nuk ishte në pajtueshmëri me rregullën 35.6. Komisionet është dashur t’i bëjnë kërkesat e tilla para skadimit të afatit prej dy muajve për shqyrtimin e projektligjit.*

- Në takimin e 16 marsit, Kryesia diskutoi mocionin e parashtruar nga z. Riza Smaka (AKR) me propozimin që Kuvendi të udhëzojë qeverinë të përgatisë ligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbytjet e dëmshme. Kryesia vendosi që të kërkojë mendim nga qeveria në lidhje me mocionet e z. Smaka. Megjithatë, qeveria ende nuk ka dhënë mendim mbi këtë çështje.

*Koment: Vendimi i Kryesisë ishte në pajtim me rregullën 34.1, e cila përcakton se “Në rastet kur deputeti i Kuvendit ia paraqet Zyrës për Propozime dhe Parashtrësia një mocion që Kuvendi ta udhëzojë Qeverinë ta përgatitë një projektligj, Kryesia kërkon mendimin e Qeverisë.”*

#### Shpërndarja e draft legjisllacionit

- Projektligji për Institucionin Avokatit të Popullit është shpërndarë më 16 shkurt; projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për procedurën administrative është shpërndarë më 18 shkurt; projektligji për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimin e terrorizmit është shpërndarë më 22 shkurt; dhe projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për tatimin në vlerë të shtuar është shpërndarë më 24 shkurt. Në këtë mënyrë, projektligjet janë shpërndarë, përkatësisht, më 15, 14, 12 dhe 10 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 11 marsit.

Projektligji për administratën e shtetit është shpërndarë më 18 janar, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ujitjen e tokave bujqësore është shpërndarë më 15 mars, projektligji për gjykatat është shpërndarë më 22 mars, projektligji për grevat është shpërndarë më 31 mars; dhe projektligji për energjinë elektrike është shpërndarë më 1 prill. Prandaj, projektligjet janë shpërndarë, përkatësisht, 58, 19, 14, 7 dhe 6 ditë punë para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 15 prillit.<sup>10</sup>

Projektligji për konteste administrative është shpërndarë më 6 prill, projektligji për metrologji është shpërndarë më 8 prill, dhe projektligji për tatimin në pronë të paluajtshme është shpërndarë më 20 prill. Prandaj, projektligjet janë shpërndarë, përkatësisht më 15, 13 dhe gjashtë ditë pune para shqyrtimit të parë në seancën plenare të 29 prillit.

<sup>10</sup> Vëreni se shqyrtimi i parë i projektligjit për administratën shtetërore fillimisht është planifikuar të bëhet në seancën e 11 shkurtit, por është shtyrë për shkak të mungesës së Ministrisë të Administratës Publike, i cili është dashur ta prezantojë projektligjin para Kuvendit. Për më shumë, shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë 01/2010 për monitorimin Kuvendit të Kosovës.

*Koment: Rregulli 35.1 kërkon që Shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij. Kështu, pesë nga projektligjet e përmendura – projektligji për administratën shtetërore, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ujitje të tokës bujqësore, projektligji për greva, projektligji për energji elektrike dhe projektligji për tatimin në pronën e paluajtshme – nuk janë shqyrtuar në leximin e parë siç kërkohet nga Rregulli 35.1. Projektligji për administratën shtetërore dhe projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ujitjen e tokave bujqësore janë shqyrtuar në shqyrtimin e parë më tepër se tri javë të punës pas shpërndarjes së tyre, derisa shqyrtimi i parë i projektligjit për grevat, projektligji për energjinë elektrike dhe projektligji për tatimin mbi pronën e paluajtshme u bënë më herët se dhjetë ditë pas shpërndarjes së tyre. Është me rëndësi që të ketë një planifikim më të mirë të shqyrtimeve të para të projektligjeve në mënyrë që të shmanget vonimi i miratimit të tyre.*

#### Kuvendi miraton rregulloren e re të punës

- Gjatë seancës plenare të 29 prillit, Kuvendi në shqyrtimin e dytë ka miratuar rregulloren e re të punës, përfshirë 57 plotësime dhe ndryshime. Rregullorja e re e punës ka përfshirë disa dispozita të reja e të rëndësishme, të cilat synojnë përmirësimin dhe funksionalizimin e Kuvendit, veçanërisht në fushën e mbikëqyrjes së ekzekutivit, rishikimit legjislativ, mbikëqyrjes së institucioneve të pavarura dhe për transparencë ndaj publikut. Dispozitat e reja ofrojnë mundësi më të mira për rregullimin më me efikasitet të pyetjeve për qeverinë dhe interpelancat, që janë instrumente kyçe të mbikëqyrjes në duart e Kuvendit. Rregullorja e re e punës gjithashtu paraqet një kornizë që synon përmirësimin e ndërveprimit ndërmjet Kuvendit dhe institucioneve të pavarura, duke u përqendruar në veçanti në raportimin e institucioneve të pavarura para Kuvendit, gjë që nuk ishte e rregulluar në Rregulloren e mëparshme të punës. Përveç kësaj rregullorja e re e punës ofron dispozita më të qarta në kanalizimin e procesit të rishikimit legjislativ dhe rritjen e llogaridhënies së kuvendit drejt zgjedhësve të saj përmes publikimit të të dhënave të votimeve elektronike të seancave plenare.

*Koment: Pas zgjedhjeve të nëntorit të vitit 2007 për Kuvendin e Kosovës dhe pas fillimit të mandatit të tretë, Komisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Punës filloi hartimin e Rregullores së re të punës. Projekti i ri u aprovua në shqyrtimin e parë në seancën plenare të mbajtur më 11 dhjetor 2008. Mirëpo, projekti i Rregullores së re të punës mbeti në pritje në Kuvend për më tepër se një vit pas aprovimit të tij në shqyrtimin e parë sepse Komisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Punës dhe Kryesia e Kuvendit nuk mundën që t'i harmonizojnë pikëpamjet e tyre. Rregullorja e re e punës ka hyrë në fuqi nga dita e miratimit të saj. Raporti tjetër i monitorimit do të bazohet në respektimin e Rregullores së re të punës.<sup>11</sup>*

#### Shqyrtimet nga Kuvendi të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura për vitin 2009

<sup>11</sup> Si pjesë e hartimit të Rregullores së re të punës, Komisioni ka mbajtur një seminar në Korrik të vitit 2007, i cili u ndihmua nga OSBE-ja, i cili ofrojë mundësinë për përgatitjen e projektit fillestar të Rregullores së re. OSBE-ja ofrojë një numër të sugjerimeve dhe imputeve procedurale për Rregulloren e re të punës, në bazë të gjetjeve dhe vështrimeve të ekipit të saj monitorues gjatë mandatit të dytë të Kuvendit. Sugjerimet e OSBE-së përfshinin përmirësimin e funksioneve kryesore të Kuvendit, siç është mbikëqyrja e ekzekutivit, procesi legjislativ dhe llogaridhënia e Kuvendit.



- Më 29-30 prill, Kuvendi shqyrtojë raportet vjetore për vitin 2009 të pesë institucioneve të pavarura si në vijim:
  - Raportin e Komisionit të Pavarur për Media,
  - Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit,
  - Raportin e Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik,
  - Raportin e Organit Shqyrtues të prokurimit,
  - Raportin e Trustit Pensional të Kosovës.

Kuvendi i shqyrtoi raportet në mënyrë të thukët duke lënë kohë të mjaftueshme për diskutime dhe duke lejuar komisionin funksional përgjegjës për secilin institucion që të japë një pasqyrim hyrës. Gjatë diskutimit, si deputetët e pozitës ashtu edhe ata të opozitës në Kuvend, ndanë mendimin që funksionimi dhe puna e institucioneve të pavarura nuk duhet të kenë presion dhe ndikim politik. Kuvendi i ka miratuar raportet vjetore të Komisionit të Pavarur për media, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik dhe Organit Shqyrtues të Prokurimit, por refuzoi raportin e Trustit Pensional të Kosovës (TPK), sepse raporti është konsideruar që nuk jep një vlerësim të vërtetë të aktiviteteve për vitin 2009 dhe përmbante vetëm pasqyra financiare, të nxjerra nga baza e të dhënave e TPK-së. TPK është kërkuar që të plotësojë raportin e vet dhe ta paraqesë atë sërish në Kuvend.

*Koment: OSBE-ja ka vërejtur që më shumë institucione të pavarura kanë paraqitur raportet e tyre vjetore në vitin 2010 se sa në vitet e kaluara. Një gjë tjetër edhe më pozitive është trendi në rritje e sipër në Kuvend për diskutimin e shqyrtimin e thukët të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura, dhe ai i ofrimit të rekomandimeve. Diskutime më të shumta bëhen në nivel të komisioneve, dhe janë duke u bërë përpjekje më proaktive nga Kuvendi për të bashkëpunuar me institucionet e pavarura.*

#### Kuvendi hasë në vështirësi në menaxhimin e periudhave të pyetjeve parlamentare

- Gjatë periudhës së pyetjeve në seancën plenare të mbajtur më 11 mars 14 pyetje janë parashtruar nga deputetët, nga të cilat 12 pyetje kanë marrë përgjigje nga qeveria. Në seancën plenare të 1 prillit, janë përfshirë gjithsej 30 pyetje në periudhën e rregullt të pyetjeve për qeverinë për të marrë përgjigje gojore. Nga 30 pyetje, 8 pyetje ishin nga seanca e mëparshme dhe 22 pyetje ishin të reja. Mirëpo, vetëm dhjetë pyetje pranuan përgjigje dhe 20 pyetje tjera u shtynë për seancën e radhës meqë koha për periudhën e pyetjeve kishte kaluar. Në seancën plenare të 15 prillit, 23 pyetje ishin përfshirë në periudhën e rregullt të pyetjeve për qeverinë për përgjigje gojore, nga të cilat 7 pyetje ishin bartur nga seanca e kaluar dhe 16 ishin pyetje të reja. Nga 23 pyetje, vetëm 11 pyetje pranuan përgjigje dhe 12 pyetje tjera u shtyn për seancën e radhës pasi që kishte kaluar koha e ndarë për pyetje. Në seancën plenare të 29 prillit, nëntë nga 13 pyetjet pranuan përgjigje nga qeveria.

*Koment: Periudhat e pyetjeve gjatë periudhës raportuese u mbajtën nga Kuvendi në përputhshmëri me rregullin 26 “Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë”, i cili parasheh që Rendi i ditës për secilën seancë të Kuvendit do të përfshijë një periudhë për pyetje, e cila do të kufizohet në pesëdhjetë (50) minuta për pyetjet e deputetëve për qeverinë, me një minutë për parashtrimin e pyetjes, tre minuta për përgjigjen e ministrit, një minutë për pyetjen plotësuese, dhe dy minuta për përgjigje në pyetjen plotësuese.*

*Më herët dhe gjatë kësaj periudhë raportuese është vërejtur që jo të gjitha pyetjet kanë mundur të procedohen gjatë periudhës 50 minutëshe për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara nga deputetët. Vlen të përmendet që Komisioni për Rregullore të*

*punës ka përfshirë dispozita të reja në projektin e Rregullores së re të punës, sipas së cilës periudha e pyetjeve do të zgjasë deri 60 minuta dhe një deputet do të kishte të drejtën që të parashtojë vetëm dy pyetje gjatë një séance plenare. Dispozitat e reja synojnë që ta bëjnë periudhën e pyetjeve më efektive duke u dhënë deputetëve që parashtojnë pyetje, mundësi më të mirë për të pranuar përgjigje me kohë. Mirëpo, mungesa e qeverisë për t'u përgjigjur në pyetje krijon vështirësi për Kuvendin në menaxhimin e duhur të periudhave të pyetjeve dhe shpesh pyetja e humbë rëndësinë e vet. Prandaj, kuvendi duhet të bëjë më shumë përpjekje dhe të përdorë autoritetin e vet për të siguruar llogaridhënie të qeverisë, që është një funksion demokratik kyç i një parlamenti.*

#### **4. Qasja**

- Gjatë periudhës së raportimit, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka vazhduar që të ketë qasje në seancat plenare, mbledhjet e kryesisë dhe komisioneve. Misioni i OSBE-së në Kosovë gjithashtu ka pranuar kopje të dokumenteve që janë shqyrtuar nga Kuvendi dhe transkriptet e seancave plenare.

#### **5. Transparenca**

Kuvendi nuk i ka publikuar të dhënat nga votimi elektronik në seancat plenare që janë mbajtur gjatë periudhës raportuese.

*Koment: Në seancën plenare të mbajtur më 15 shkurt 2008, kryetari i Kuvendit theksoi që kuvendi do t'i publikojë të dhënat e votimeve elektronike të vendimeve të seancave plenare në faqe të internetit. Pas shpalljes së kryetarit, Kuvendi fillojë publikimin e të dhënave nga votimi elektronik nga seanca e jashtëzakonshme e mbajtur më 17 shkurt 2008, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Prandaj, rekomandohet që Kuvendi t'i publikojë në mënyrë vazhdueshme të dhënat nga votimi elektronik që të rrisë transparencën e Kuvendit, e në veçanti llogaridhënien e deputetëve të Kuvendit drejt votuesve të tyre.*

- Radio Televizioni i Kosovës ka siguruar transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare në shqyrtim. Publikut dhe monitoruesve ndërkombëtarë u është mundësuar qasja në seancat plenare. Kuvendi e ka faqen e internetit ([www.kuvendikosoves.org](http://www.kuvendikosoves.org), [www.skupstinakosova.org](http://www.skupstinakosova.org), [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)) në të cilën përmbahen të dhëna biografike të Deputetëve, informata lidhur me strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbalet dhe transkriptet e seancave të kuvendit dhe takimeve të komisioneve, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi së bashku me informata tjera.

FUND